

**Edhe Fëmiju im
Ka të drejtë
Të Arsimohet**



**DORACAK MBI GJITHËPËRFSHIRJEN E FËMIJËVE ME NEVOJA
TË VEÇANTA NË INSTITUCIONET ARSIMORE**




**Edhe Fëmiju im
Ka të drejtë
Të Arsimohet**

PËRMBAJTJA

Shkurtesat	2
Definimi i Terminologjisë	2
Kapitulli I: Hyrje	3
Qëllimi i doracakut	3
E drejta në gjithëpërfshirje	3
Rëndësia e intervenimit të hershëm	5
Kapitulli II: Kompetencat kryesore të instituconeve në gjithëpërfshirjen e nxënësve me nevoja të veçanta në arsim dhe Legjislacioni Relevant	7
Kompetencat në nivel qendror dhe komunal	7
Legjislacioni, Strategjitë dhe Dokumentet relevante	9
Kapitulli III: Shërbimet përgjatë procesit të gjithëpërfshirjes së fëmijëve\ nxënësve me nevoja të Veçanta në arsim	14
Shërbimet që ofrohen në nivel qendror dhe komunal	14
Procesi i regjistrimit të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore	18
Planet që hartohen për fëmijë me nevoja të veçanta në arsim	19
<i>Plani individual arsimor</i>	19
<i>Planifikimi i tranzicionit (faza kalimtare) dhe zbatimi</i>	20
Kapitulli IV: Roli i Prindërve\familjes dhe të drejtat e tyre	23

● ● ● SHKURTESAT

DANV	Divizioni i arsimit për nevoja të veçanta
DKA	Drejtoritë komunale të arsimit
DPAP	Departamenti për politika në arsimin parauniversitar
IAK	Inspektoriati i Arsimit në Komunë
NVA	Nevoja të veçanta arsimore
MASHT	Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë
MMPH	Ministria e mjedisit dhe planifikimit hapësinor
PIA	Plani individual arsimor
QB	Qendrat burimore
UNESCO	United Nations Educational, Scientific and Cultural Organization



DEFINIMI I TERMINOLOGJISË

Ky doracak është hartuar nga Ministria e arsimit, shkencës dhe teknologjisë (MASHT), Handikos dhe Save the Children dhe shtjellon kompetencat, rolet, përgjegjësitë dhe sugjerimet për gjithëpërfshirjen në arsim. Në këtë dokument përdoren dy terme për aftësinë e kufizuar ('aftësi e kufizuar' dhe 'nevoja të veçanta') duke qenë se në legjislacionin dhe dokumentet zyrtare të MASHT-it përdoret termi 'Nevoja të veçanta arsimore', ndërsa në ligjet tjera njihet si term 'aftësi e kufizuar'. Ky i fundit është term i cili pranohet nga vet personat me aftësi të kufizuar dhe është term që përdoret edhe nga vet Handikos. Mirëpo vetëm për këtë doracak partnerët e lartpërmendur janë pajtuar që kur flitet për fëmijë me aftësi të kufizuar me theks në ARSIM – do të përdoret termi 'fëmijë me nevoja të veçanta arsimore'.

Sipas Ligjit Nr.04/L-032 për arsim parauniversitar në Republikën e Kosovës, neni 39 – 'Fëmijët me nevoja të veçanta arsimore janë fëmijet me vështirësi në mësim dhe fëmijët që janë me aftësi të kufizuar'.

● ● ● KAPITULLI I: HYRJE



QËLLIMI I DORACAKUT

Ky doracak është bërë me qëllim të lehtësimit të punës së të gjitha palëve që përfshihen në cilëndo fazë të gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevojave të veçanta në arsim, duke filluar nga institucionet në nivel qendror, nivel lokal, shkolla e deri tek prindërit.

Ky doracak fillimisht shpjegon kompetencat që i kanë institucionet e vendit në bërjen e politikave rreth gjithëpërfshirjes së personave me nevoja të veçanta. Më pas fokusohet tek rolet dhe përgjegjësitë e të gjitha institucioneve në ofrimin e shërbimeve për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore, duke filluar nga MASHT, DKA-të e deri tek Shkollat. Më pas përshkruhet se si bëhen planet për këta fëmijë në mënyrë që procesi i arsimit për fëmijë me nevoja të veçanta arsimore të jetë sa më i lehtë dhe i suksesshëm. Në fund përshkruhet roli i prindërve në këtë proces ku janë përmbledhur edhe disa këshilla për prindër në procesin e regjistrimit të fëmijëve të tyre në shkollë apo në rast se janë të pakënaqur me shërbimet në institucionet arsimore.

E DREJTA NË GJITHËPËRFSHIRJE

Gjithëpërfshirja në arsim ka si synim përfshirjen e të gjithë fëmijëve pa dallim race, gjinie, etnie, nevoje të veçantë apo ndonjë dallim tjetër në shkollën më të afërt të rregullt.¹ Kjo konsiderohet si hap i rëndësishëm drejt përfshirjes sociale të fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim dhe është dëshmuar si metodë shumë më e suksesshme se sa kyçja në shkolla të veçanta.

"...shkollat duhet të akomodojnë fëmijët pavarësisht nga gjendja e tyre fizike, intelektuale, sociale, emocionale, gjuhësore ose ndonjë gjendje tjetër. Kjo duhet të përfshijë fëmijët me aftësi të kufizuara dhe fëmijët me talent, fëmijët e rrugës dhe fëmijët që punojnë, fëmijët nga viset e larta dhe popullatat nomade, fëmijët e minoriteteve gjuhësore, etnike ose kulturore dhe fëmijët nga viset apo grupet e marginalizuara" – UNESCO (1994, Korniza për Veprimin për nevoja të veçanta në arsim, f.6)

● ● ● Marrë nga 'Arsimi gjithëpërfshirës: E drejtë e secilit' (2014) publikuar nga MASHT. <https://masht.rks-gov.net/uploads/2015/06/arsimimi-06-06-2014-3.pdf>

Në Kosovë gjithëpërfshirja është ende kocept dhe praktikë e re, mirëpo është arritur shumë progres në këtë aspekt. Legjislacioni që e adreson këtë çështje është në zbatim, dhe për më tepër ekziston edhe Plani i ri strategjik për organizimin e arsimit gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevojave të veçanta në Kosovë 2016-2021. Sidoqoftë duke qenë se është ende në fazat e para të zbatimit, gjithëpërfshirja e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim është ende sfidë në Kosovë.

Asnjë nxënës nuk mund të përjashtohet nga arsimi i detyruar për shkak të nevojës së veçantë. Në rast se fëmija është me aftësi të kufizuar të nivelit të lartë, atëherë arsimi i detyruar merret në Qendrat burimore. Shkollimi i detyruar mbaron me përfundimin e vitit të nëntë të shkollimit.

Shkollat e kanë zonën e vet të mbulimit dhe të gjithë nxënësit e moshës së arsimit të detyruar, që banojnë në atë zonë, kanë të drejtë të regjistrohen dhe të ndjekin shkollën e nivelit përkatës. Prindërit janë të detyruar që sipas ligjit të regjistrojnë fëmijët për të ndjekur arsimin e detyruar 9 vjeçar (5+4).

Sfidë përgjatë shkollimit të detyruar është edhe qasja fizike në shkollë për një numër të fëmijëve aftësi të kufizuar fizike. Liria e lëvizjes është një ndër të drejtat e shumta të përcaktuara për personat me aftësi të kufizuar, ndërsa ajo bëhet e drejtë themelore kur i njehti person/fëmijë fillon shkollimin. Qasja për fëmijët me aftësi të kufizuar në shkollë, nënkupton ambient pa barriera, me hapësirë të qasshme, si për brenda ashtu edhe për jashtë. Në Kosovë shumë ligje e udhëzime administrative e adresojnë qasjen në shkollë të fëmijëve me aftësi të kufizuar, sipas të cilave MASHT duhet të ofroj ndihmë teknike komunave për të siguruar përshtatshmërinë e ndërtesave/objekteve shkollore dhe të pajisjeve sipas standardeve ndërkombëtare për shëndet dhe siguri, si dhe për mbrojtje të mjedisit. E tërë kjo për të siguruar qasje të nxënësve, por edhe punonjësve me aftësi të kufizuar dhe pajisje ndihmëse për përkrahjen e arsimit gjithëpërfshirës.

••• Rëndësia e intervenimit të hershëm

Intervenimi i hershëm nënkupton një sistem të shërbimeve të dizajnuara për t'u ndihmuar fëmijëve nevoja të veçanta arsimore drejtpërdrejtë dhe përmes ofrimit të mbështetjes prindërve të tyre në moshën e hershme. Fëmijëria e hershme është moshë kur fëmijët zhvillohen më shpejtë se në cilëndo moshë tjetër dhe është periudha kur fëmija hulumton (eksploron) ambientin përreth përmes shqisave të prekurit, të pamurit, të shijuarit, të dëgjuarit dhe të nuhaturit, ndërkohë që ngacmimi i këtyre shqisave nxit proceset dhe zhvillimin motorik, kognitiv, të gjuhës dhe komunikimit, si dhe zhvillimin socio-emocional. Shumë nga shkathtësitë jetësore themelore mësohen dhe zhvillohen në tri vitet e para të jetës, siç janë shkathtësitë kognitive-njohëse; socio-emocionale; komunikimi dhe gjuha; si dhe vetë-kujdesi.

Prandaj është e rëndësishme që të mendohet për intervenim të hershëm duke qenë se jo vetëm që nxitë zhvillimin e fëmijëve me nevoja të veçanta/aftësi të kufizuar por edhe e minimizon vonesën në zhvillim (njëkohësisht duke i redukuar shpenzimet dhe minimizuar nevojën për shërbimet arsimore të veçanta). Intervenimi i hershëm është me efektiv dhe me pak i kushtueshëm nëse ofrohet me herët në moshë, e sidomos përgjatë periudhës 0-3 vjeç.

Edhe Fëmiju im
Ka të drejtë
Të Arsimohet



Edhe Fëmiju im
Ka të drejtë
Të Arsimohet

● ● ● KAPITULLI II: KOMPETENCAT KRYESORE TË INSTITUCONEVE NË GJITHEPËRFSHIRJEN E NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË ARSIM DHE LEGJISLACIONI RELEVANT

KOMPETENCAT NË NIVEL QENDROR DHE KOMUNAL

Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë (MASHT), gjegjësisht Divizioni për Arsim me Nevoja të Veçanta (DANV) është përgjegjëse për hartimin dhe monitorimin e politikave në fushën e arsimit të fëmijëve me nevoja të veçanta duke u bazuar në parimin e arsimit gjithëpërfshirës, i cili është pjesë integrale e të gjitha politikave të MASHT-i. Si e tillë bën të mundur që arsimit në Kosovë të jetë në përputhje me trendet bashkëkohore të arsimit. Përpjekjet për arsim gjithëpërfshirës kanë filluar vite me herët, por me Ligjin për arsimin parauniversitar 2011 dhe ligjet tjera, arsimit gjithëpërfshirës tani është realitet dhe si i tillë ka bërë që koncepti i gjithëpërfshirjes të bëhet pjesë e të gjitha politikave të MASHT-it.

Në kuadër të departamentit për politika në arsimin parauniversitar (DPAP) funksionon Divizioni për Arsim me Nevoja të Veçanta i cili punon në këto fusha:

- Zhvillimin e politikave për arsim gjithëpërfshirës, me theks të veçantë fëmijëve me nevoja të veçanta;
- Planifikimin dhe menaxhimin e buxhetit për arsimin me nevoja të veçanta;
- Menaxhimin e stafit që punon me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore në Qendra Burimore;
- Koordinimin dhe planifikimin e aktiviteteve në fushën e arsimit gjithëpërfshirës me institucione, komuna dhe organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare;
- Monitorimin dhe mbarëvajtjen e punëve në Qendra burimore përfshirë: planifikimin e punës pedagogjike, punën e shërbimeve të mbështetjes, planifikimin e buxhetit dhe shpenzimin e buxhetit dhe identifikimin e nevojave për këshilla përkrahëse;

- Promovimin e arsimit gjithëpërfshirës përmes veprimeve konkrete të cilat sigurojnë rritjen e pjesëmarrjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar me fokus të veçante tek fëmijët që janë jashtë sistemit të arsimit;
- Monitorimin e cilësisë së procesit të arsimit të nxënësve me nevoja të veçanta arsimore në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar;
- Bashkëpunimin dhe koordinimin me organizatat e ndryshme vendore dhe ndërkombëtare për aktivitetet dhe iniciimin e programeve dhe projekteve të cilat do të përmirësojnë gjendjen e arsimit me nevoja të veçanta dhe promovojnë arsimin gjithëpërfshirës.



Kompetencat në organizmin e edukimit të përgjithshëm janë bartur nga niveli qendror në ate komunal që nga viti 2010, ndërsa kompetencat që kanë të bëjnë me gjithëpërfshirjen në arsim për fëmijë me nevoja të veçanta janë bartur në nivel lokal në vitin 2014. Kjo bartje e vonuar ka ndodhur për shkak të specifikave që ka arsimi me nevoja të veçanta për shkak se ka pasur nevojë që fillimisht të vendoset/krijohet sistemi për zbatimin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim. Mirëpo tashmë kompetencat kryesore që lidhen me arsimin e përgjithshëm, përfshirë kompetencat që lidhen me gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim, janë të Drejtorive komunale të arsimit.

● ● ● LEGJISLACIONI, STRATEGJITË DHE DOKUMENTET RELEVANTE

Ligjet, Udhëzimet Administrative, dokumentet strategjike dhe të tjera në bazë të të cilave është përgatitur ky doracak e që e adresojnë gjithëpërfshirjen e fëmijëve/nxënësve me nevoja të veçanta në arsim, janë të listuara në vazhdim:

● **Ligji mbi arsimin parauniversitar në Republikën e Kosovës 2011** – ku gjithëpërfshirja si koncept e përshkon tërë ligjin i cili është i bazuar në deklaratën e Salamankës mbi gjithëpërfshirjen dhe Konventën mbi të drejtat e njeriut. Ligji ka edhe nenet 40, 41, 43 dhe 44 të cilat rregullojnë arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim. Në kuadër të kësaj janë hartuar 7 udhëzime administrative për arsimin me nevoja të veçanta që dalin nga Ligji për Arsim Parauniversitar:

- UA 07/2012 Vlerësimi profesional i fëmijëve me nevoja të veçanta edukative-arsimore;
- UA 12/2012 Kriteret për përzgjedhjen e asistentëve dhe instruktoreve për arsim gjithëpërfshirës dhe obligimet e tyre;
- UA 26/2012 Kualifikimi për personelin që punon me nxënësit me nevoja të veçanta arsimore;
- UA 18/2013 Përdorimi i planit individual të arsimit;
- UA 22/2013 Numri maksimal i nxënësve për klasë dhe raporti mësimdhënës-nxënës;
- UA 23/2013 Qendrat burimore;
- UA 24/2014 Shndërrimi i klasave të bashkëngjitura në dhoma të burimeve

- Korniza e kurrikulumit të Kosovës (KKK) 2010 – ku një nga parimet kryesore mbi të cilat është ndërtuar ky dokument është gjithëpërfshirja. KKK është në linjë me Arsimin për të Gjithë dhe Qëllimet Zhvillimore të Mileniumit;
- Standardet e zhvillimit dhe të mësuarit në fëmijërinë e hershme 0-6 vjet (2011) – që sigurojnë qasje gjithëpërfshirëse në edukimin e hershëm, ku në qendër është fëmija dhe arritjet e tij në periudha të caktuara të moshës dhe në fusha të ndryshme zhvillimi;
- Standardet për shkollat mike për fëmijë, 2012 – koncepti i shkollave mike për fëmijë mbështetet në Konventën për të Drejtat e Fëmijës dhe paraqet qasje gjithëpërfshirëse që ndërlidhë aspektet e reformës në arsim dhe e cila e vendos fëmijën në qendër të vëmendjes në të gjitha aktivitetet që organizohen dhe zbatohen në shkollë;
- Plani Strategjik për Arsimin e Kosovës 2011-2016 (PSAK) – është një plan pesëvjeçar ku arsimi i fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore i referohet Planit strategjik për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar;
- Plani strategjik 5 vjeçar për arsimin gjithëpërfshirës të fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në arsimin parauniversitar (2016-2021) – është plan strategjik që përcakton në mënyrë të strukturuar dhe të integruar, se si i duhet qasur dhe se si të trajtohet çështja e procesit të gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në sistemin e rregullt shkollor.

$$\frac{24 \times 5 (8+3)}{33-12}$$

Edhe Fëmiju im
Ka të drejtë
Të Arsimohet







Të mësuarit nuk njih kufijë

● ● ● KAPITULLI III: SHËRBIMET PËRGJATË PROCESIT TË GJITHËPËRFSHIRJES SË FËMIJËVE\NXËNËSVE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË ARSIM

SHËRBIMET QË OFROHEN NË NIVEL QENDROR DHE KOMUNAL

Tashmë në Kosovë ekzistojnë shkollat gjithëpërfshirëse që promovojnë dhe sigurojnë edukim dhe arsimim për të gjithë fëmijët. Gjithëpërfshirja është proces i cili nuk mund të arrihet brenda një kohe të shkurtër dhe kjo kërkon ndryshimin e vazhdueshëm të sistemit arsimor, të shkollës por edhe të vete mësimdhënësit për ta bërë atë më fleksibil, më të përshtatshëm për t'ju përgjigjur nevojave dhe larmisë së nxënësve. Synimi është, që shkolla të jetë një vend ku çdo fëmijë apo nxënës të ketë mundësi të shpalosë vlerat individuale, të ndjehet i pranuar dhe i vlerësuar dhe të përfitojë maksimalisht nga procesi mësimor.

Me qëllim të krijimit të kushteve më të mira për mësimnxënje, MASHT nga viti 2009 ka përfshirë edhe disa profile të reja të stafit profesional për arsimin e fëmijëve\ nxënësve me nevoja të veçanta arsimore, të cilët e kanë rolin e mbështetjes profesionale dhe asistencës nëpër institucione parashkollore dhe shkolla. Këto profile të mësimdhënësve tani janë aktive në disa institucione parashkollore dhe shkolla dhe janë nën kompetencë të Drejtorive Komunale të Arsimit dhe vet shkollave. Roli i MASHT-it është që të ngrisë kapacitetet dhe njohuritë e të gjitha këtyre profileve të reja në aspektin e gjithëpërfshirjes së fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim përmes trajnimeve të ndryshme që ofrohen nga institucionet, organizatat dhe Qendrat burimore.

Qendrat burimore për mësim dhe këshillim kanë 17 programe të akredituara nga MASHT për trajnimin e mësimdhënësve dhe edukatorëve për tema specifike në punë me fëmijë me nevoja të veçanta arsimore. Programet e miratuara janë për Qendrat Burimore për mësim dhe këshillim në Prishtinë, Pejë, Prizren dhe Mitrovicë, me tema: Zbatimi i planit individual të Arsimit; Prodhimi i materialit didaktik; Qasja metodologjike në mësimdhënie; Arsimi gjithëpërfshirës; Hartimi i PIA-së; Fushat e Edukimit Special dhe veçoritë e punës me nxënës me nevoja të veçanta arsimore; Plani Individual trajnimi në gjuhën boshnjake; Fëmijet me autizëm; Mësimi i shkrimit Brail; Karakteristikat e fëmijëve me dëmtime në të parë; Intervenimi i hershëm; Trajnime për orientim dhe mobilitet; Përdorimi i teknologjisë informative për të verbër; Shkolla për të gjithë: trajnim hyrës dhe i avancuar.



Profilet që janë krijuar për gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim (e që bazohen në legjislacionin dhe dokumentet përcjellëse të MASHT-it) e që menaxhohen dhe koordinohen në nivel lokal (nga DKA-të dhe shkollat) janë:

Zyrtari për arsim gjithëpërfshirës, i cili ka për detyrë që së bashku me Drejtorinë komunale të arsimit të zhvillojë politikë gjithëpërfshirëse për aktivitete të ndryshme që janë në harmoni me politikat e MASHT-it për arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore. Përgjegjësi e këtij zyrtari është që të koordinoj të gjithë akterët që punojnë në gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsim, duke filluar nga koordinimi i mësimdhënësve; koordinimi dhe planifikimi i ekipit vlerësues; koordinimi dhe bashkëpunimi me shkollat speciale/qendrat burimore dhe shkollat gjithëpërfshirëse/klasat e bashkangjitura në krijimin kushteve relevante në këtë fushë; bashkëpunimi i ngushtë me DANV-në në kuadër të MASHT-it, ku ndër të tjera edhe për aftësimin profesional të mësimdhënësve që punojnë me fëmijët me nevoja të veçanta në arsim; bashkëpunimi me organizata të ndryshme vendore dhe ndërkombëtare që punojnë në këtë fushë; monitorimin e cilësisë së arsimit, njëkohësisht duke bërë edhe identifikimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore dhe organizimin e transportit të përshtatshëm për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore; dhe mbi të gjitha iniciimin e aktivitete dhe promovimin e arsimit gjithëpërfshirës, me qëllim të përmirësimit të gjendjes në arsimin e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore

Ekipi vlerësues, është ekip profesional vlerësues dhe përkrahës për nevojat e veçanta arsimore, i përbërë nga specialistë të arsimit, punës sociale, psikologjisë dhe të rehabilitimit, si mbështetje e jashtme për institucionet arsimore dhe aftësuese për të ofruar këshillime dhe udhëzime për mësimdhënësit, nxënësit dhe prindërit. Çdo komunë duhet që vetë, apo në bashkëpunim me komunat e tjera të themelojë këtë ekip profesional vlerësues. Procedura e punës/vlerësimit të fëmijës nga ekipi profesional mund të fillohet me kërkesën e ndonjë prindi apo institucioni arsimor ose aftësues me pëlqimin e prindit. Në përputhje me parimet e arsimit gjithëpërfshirës dhe duke pasur parasysh nevojat individuale të fëmijës/nxënësit ekipi vendos për tipin e shkollës dhe llojin e mësimdhënies që duhet t'i ofrohet. Ministria, me akt nënligjor, përcakton procedurat dhe afatet kohore për vlerësimin profesional. Nëse vendimi i komunës ndryshon nga vlerësimi profesional i ekspertëve, arsyet për vendimin e komunës duhet të shpjegohen me shkrim. Prindërve u jepet mundësia të bëjnë ankesë me shkrim. Në raste të tilla, Ministria do të sjellë vendimin përfundimtar dhe ajo mund të konsultohet me këta ekspertë siç e përcakton vet. Përmbajtja e mësimdhënies për nxënësit me nevoja të veçanta për arsim përcaktohet në Planet individuale të arsimit. Procedura dhe modeli i këtyre planeve rregullohet me akt nënligjor.

Qëllimi i vlerësimit që bëhet nga Ekipi vlerësues është:

- për të vlerësuar aftësitë, interesimet dhe nevojat e fëmijës;
- për të dhënë rekomandime mbi metodat e mësimdhënies, mjetet e mësimdhënies dhe mbi përshtatjet e tjera të nevojshme për mësimnxënie dhe mirëqenie të fëmijës;
- për të përkufizuar nevojat për pajisjet të posaçme që nevojiten në mësimdhënie;
- për të dhënë rekomandime për regjistrimin e nxënësit.



Raporti i plotësuar nga ekipi vlerësues i jepet prindit, DKA-së (gjegjësisht zyrtarit për arsim gjithëpërfshirës) dhe shkollës (gjegjësisht drejtorit të shkollës i cili e ndanë atë me mësuesin apo kujdestarin e klasës ku vendoset fëmija/nxënësi).

Ekipi vlerësues përpilon një profil të fëmijës me vlerësimin e aftësive dhe shkathtësive poseduese dhe rekomandon nevojën për t'i zhvilluar ato. Ky ekip gjithashtu rekomandon edhe hartimin e Planit individual të arsimit (PIA) sipas lëndëve të individualizuara dhe sipas fushave të aktiviteteve. Ekipi vlerësues gjithashtu rekomandon llojin e arsimit për fëmijën si: Institucion parashkollor, shkollë e rregullt ose qendër burimore.

Mësuesi mbështetës, roli i së cilit është identifikimi i fëmijëve me nevoja të veçanta dhe me vështirësi në mësim në shkolla, gjegjësisht klasa të rregullta me qëllim të përkrahjes për zhvillimin e potencialit të atij fëmije për mësim.


Brenda shkollës mësuesi mbështetës në bashkëpunim me mësime dhënësit klasor/kujdestarët identifikojnë fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Po i njëjti përpilon planin individual të arsimit bashkërisht me mësime dhënësin e rregullt, prindin dhe anëtarët tjerët të ekipit të PIA-s dhe po ashtu ndihmon në vetëdijësimin e stafit të shkollës për procesin e gjithëpërfshirjes. Këshillon dhe ndihmon mësime dhënësit e rregullt se si të punohet me fëmijët me nevoja të veçanta arsimore dhe si menaxhohet me klasën gjithëpërfshirëse, duke hartuar bashkërisht edhe materialet mësimore alternative. Bashkëpunon me qendrat burimore rreth metodave të mësimdhënies, materialeve mësimore dhe rreth mbështetjes së nevojshme për nxënësit. Mbi të gjitha ky profil ka për qëllim të identifikon nxënësit me nevoja të veçanta në shkollat e rregullta dhe institucione e tjera dhe të ndihmoj në integrimin e këtyre fëmijëve nga qendra burimore në shkollë të rregullt, si dhe nga klasët e bashkangjitura në klasët e rregullta.

Mësuesi udhëtues, roli i të cilit është të identifikoj nevojat për mbështetjen e fëmijëve me nevoja të veçanta arsimore në shkolla të rregullta. Mësuesi udhëtues identifikon nevojat e mësimdhënësve të shkollave të rregullta për trajnime, si dhe nevojat e shkollave të rregullta për mbështetje me materiale didaktike; bashkëpunon me stafin mësimor, shërbimet e mbështetjes brenda shkollës, profesionistët e tjerë si dhe me prindërit e fëmijëve; ofron mësim shtesë për nxënësit e shkollave të rregullta si dhe trajnime në kuadër të programeve të licencuara të Qendrave burimore; si dhe mban evidencë mbi numrin e nxënësve të mbështetur dhe për numrin e rasteve të identifikuara.



● ● ● PROCESI I REGJISTRIMIT TË FËMIJËVE ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE

Fëmijët me nevoja të veçanta në arsim për tu regjistruar në shkollë, apo për të vijuar shkollën, përcjellin procedurat fillestare që janë unike për të gjithë (për më shumë sqarimeve rreth regjistrimit të fëmijëve – referojuni Kapitullit IV: Roli i Prindërve/familjes dhe të drejtat e tyre në këtë dokument). Mirëpo në momentin kur bëhet vlerësimi i parë i fëmijëve nga ana e mësuesit, pedagogut dhe psikologut në shkollë, ecuria mund të ndryshoj varësisht prej aftësive, nevojave të fëmijëve dhe kushteve për ta. Kjo ecuri është paraqitur në skemën në vazhdim.



●●● PLANET QË HARTOHEN PËR FËMIJË ME NEVOJA TË VEÇANTA ARSIMORE

Në rastet kur vlerësohet se një fëmijë ka nevoja të veçanta në arsim, si dhe rastet kur një fëmijë kalon nëpër ndonjë tranzicion në shërbimet arsimore që i ofrohen – për të përgatiten plane të personalizuar duke u bazuar në nevojat dhe shërbimet që i nevojiten për përfshirjen dhe vijimin e arsimit.

Plani individual arsimor

Plani individual arsimor (PIA) është dokument zyrtar pedagogjik, i cili hartohet për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore për të cilët ekipi vlerësues ka marrë vendimin se kanë nevojë për arsim me nevoja të veçanta. PIA shërben për planifikimin sistematik të edukimit e mësimdhënies, përfshirë mbështetjen dhe përcjelljen e përparimit të fëmijës në zhvillimin e shkathtësive dhe në mësim.

Plani individual i arsimit duhet të zhvillohet përmes një procesi bashkëpunues duke përfshirë shkollën, prindërit, vet fëmijët (në rastet kur është e përshtatshme) dhe personelin tjetër gjegjës. PIA është një dokument i besueshëm dhe informatat në të mund të ndahen me të tjerët vetëm me lejen e prindit. Ky plan i referohet përshtatjes së programit edukativo-arsimor dhe fokusohet në nevojat me prioritet në të nxënit.

Në PIA përcaktohen: ●●●

- Qëllimet edukative dhe arsimore të fëmijës për periudhën që zgjat plani individual arsimor;
- Objektivat mësimore të fëmijës përmes të cilave realizohet qëllimi i vendosur;
- Metodot dhe teknikat e punës të nevojshme për të realizuar objektivat e caktuara;
- Burimet e nevojshme për shërbimet që duhet ofruar si dhe burimet eksistuese;
- Përmbajtjen e lëndëve mësimore të individualizuara ose në fusha të aktiviteteve;
- Format e vlerësimit të fëmijës;
- Personat përgjegjës për hartimin dhe zbatimin e PIA-së; dhe
- Procesin e monitorimit dhe rishikimit të tij.

Cilësia e procesit të zhvillimit të planit individual të arsimit në një mënyrë përcakton edhe cilësinë dhe efektivitetin e planit. Prandaj koordinimi i mirë i punës, bashkëpunimi dhe ndarje e mirë e përgjegjësisë në mes të akterëve të ndryshëm është thelbësore për gjatë hartimit të këtij plani.

Planifikimi i tranzicionit (faza kalimtare)⁴ dhe zbatimi

Periudhat e tranzicionit janë shumë ndjeshme për të gjithë fëmijët, e sidomos për për fëmijët me nevoja të veçanta arsimore. Andaj kujdes i veçantë duhet t'i kushtohet planifikimit të periudhave të tranzicionit të fëmijës në mënyrë që tranzicioni të jetë sa më i lehtë për fëmijën. Periudha e tranzicionit planifikohet kryesisht në rastet kur fëmija kalon:

- prej njërit institucion në tjetrin (kur ndërron vendbanimin);
- prej një niveli më të ulët të shkollimit në nivel më të lartë;
- prej shkollës speciale në shkollën e rregullt dhe anasjelltas; dhe
- Prej klasës së bashkangjitur në klasën e rregullt dhe anasjelltas.

Në mënyrë që të sigurohet kalimi efikas dhe mbështetja e vazhdueshme ky proces duhet të përgaditet dhe të planifikohet mirë. Që të ofrohet mbështetja e vazhdueshme e fëmijës pa ndonjë vonesë, të gjitha informatat relevante duhet t'i jepen shkollës së pranimit e në takimin kalimtarë dhe informatat duhet të barten nga shkolla e mëparshme e fëmijës në shkollë pranuese. Nga prindërit duhet të merret leja për bartjen e informatave në fazën e tranzicionit (kalimit). Në takim ku përgatitet plani i tranzicionit duhet të marrin pjesë: prindërit, edukatorët/mësimdhënësi i klasës/mësimdhënësi gjithëpërfshirës nga shkolla e mëparshme e fëmijës, mësuesi udhëtues nga qendra burimore nëse është e nevojshme dhe mësimdhënësi i klasës/mësimdhënësi gjithëpërfshirës dhe drejtori nga shkolla pranuese.

Një plan i mirëfillt i tranzicionit duhet t'i përmbajë informatat si në shabllonin në vazhdim.

● ● ● ⁴Planifikimi i tranzicionit (faza kalimtare) teksti është marrë prej Udhëzuesit për PIA



Një plan i tranzicionit duhet të përmbaj informatat si në vazhdim:



Përgatitja psiko-fizike e fëmijës për tranzicion

Ku përshkruhet shkurtimisht gjendja psiko-fizike e fëmijës, aftësitë, shkathtësitë dhe nevojat për mbështetje.



Përgatitja dhe planifikimi i punës me mësimitdhënësit /përgjegjësit

Ku përshkruhet shkurtimisht se si ka qenë mësimi i organizuar më parë dhe çfarë lloj mbështetjeje ka qenë e ofruar për atë fëmijë (përkrahja nga mësuesi udhëtues ose mësimitdhënësi gjithëpërfshirës; asistenti personal; mësimitdhënia individuale; mbështetja me pajisje, materiale mësimore dhe didaktike; transporti etj).



Mbështetja në fazën fillestare

Ku duhe të planifikohet së bashku me prindërit dhe mësuesit e shkollës pranuese, si dhe me mësimitdhënësin udhëtues (nëse është e nevojshme) si si të organizohet mësimi dhe mbështetja në fazën e parë në tranzicion (kalim). Kjo mund të bëhet duke iu përgjigjur pyetjeve si:

- Çfarë lloj mbështetjeje është e nevojshme;
- A ka nevojë për pajisje/ lloji i pajisjes;
- Transporti;
- Kush janë personat përgjegjës nga shkolla pranuese;
- Personi kontaktues nga shkolla e mëparshme;



Emri i pjesëmarrësve

Plani i tranzicionit duhet të nënshkruhet nga prindërit, mësimitdhënësi i shkollës dërguese si dhe mësimitdhënësi dhe drejtori i shkollës pranuese.

E rëndësishme të dihet gjatë përpilimit të planit të tranzicionit

Nga Qendra burimore në shkollë të rregullt:

A. Qendra burimore për mësim dhe këshillim fillimisht merr vendimin për integrim të fëmijës në shkollë gjithëpërfshirëse. Drejtori i shkollës kontakton shkollën gjegjëse në të cilën fëmija do të vazhdojë mësimin dhe të dy shkollat identifikojnë nevojat për gjithëpërfshirje sa më kualitative për fëmijën.

B. Mësuesi/sja e klasës gjithëpërfshirëse në bashkëpunim me mësuesin udhëtues, psikologun e shkollës, mësuesin mbështetës dhe prindin hartojnë planin individual të arsimit.

C. Qendra burimore do të ndihmojë përmes mësuesve udhëtues gjithëpërfshirjen duke përgatitur material të nevojshme, rishikuar PIA-n, dhe rivlerësimin e nevojave.

Nga Qendra burimore në shkollë të rregullt:

B. Procesi i gjithëpërfshirjes nga klasat e bashkëngjitura deri tek klasat e rregullta gjithashtu vjen me kërkesë të mësuesit/ses me klasë të bashkëngjitur për vlerësim dhe pasi që ekipet vlerësuese komunale ta kenë marrë vendimin se fëmija duhet të kalojë në klasë të rregullt.

B. Mësuesi/sja në klasë të bashkëngjitur vazhdon ta ndihmojë fëmijën dhe mësuesin/sen në proces.

● ● ● KAPITULLI IV: ROLI I PRINDËRVE\FAMILJES DHE TË DREJTAT E TYRE

Rol të rëndësishëm në përfshirjen e fëmijëve me nevoja të veçanta në arsimin e rregullt kanë edhe prindërit. Andaj, secili prind duhet të dijë që të gjithë fëmijët me aftësi të kufizuar i gëzojnë të gjitha të drejtat si bashkëmohatarët e tyre. Po ashtu prindi duhet të jetë i vetëdijshëm se fëmija, edhe pse me nevoja të veçanta arsimore, ka të drejtë të patjetërsuar për t'u arsimuar në shkollat ku mësojnë të gjithë.

E domosdoshme nga ana e prindit është që ta fuqizoj fëmijën se edhe ai e ka të drejtën për t'u mbrojtur nga diskriminimi; të drejtën për të shprehur idetë e tij; dhe të drejtën që këto ide të merren në konsideratë. Prindi është personi i parë, i cili duhet të mbrojë fëmijën në rast se mohohen të drejtat e tij, sepse në këtë mënyrë jo vetëm mund të arrihen të drejtat e fëmijëve, por fëmija merr shembull se si duhet kërkuar dhe mbrojtur të drejtat e tij kur të arrijë moshën madhore. Prindi asnjëherë nuk duhet të ndihet fajtor apo të turpërohet për aftësinë e kufizuar të fëmijës së vet, sepse kjo reflektohet direkt tek fëmija dhe ndikon negativisht gjatë rritjes dhe zhvillimit të tij.

Në mbarëvajtjen e procesit mësimor të fëmijës me nevoja të veçanta arsimore rol themelor luan edhe komunikimi i rregullt dhe bashkëpunimi i shëndoshë i prindit me shkollën dhe anasjelltas. Sinqeriteti i prindit ndaj mësimdhënësve ndikon pozitivisht në procesin mësimor të fëmijës. Mosparaqitja e specifikave të fëmijës nga ana e prindit bën që fëmija të mos arrij aq sa ka mundësi. Mirëpo edhe kujdesi i mësuesit/es në komunikimin e çdo ndryshimi të fëmijës tek prindi ndikon mjaft mirë dhe ndihmon në përcjelljen e progresit në përgjithsi të fëmijës por edhe në përcjelljen e ndonjë progresi në ndonjë fushë të veçantë që mund të jetë me perspektive për atë fëmijë.

Prindërit mund të informojnë mësimdhënësit për gjërat që ndodhin në shtëpi, të cilat mund të ndikojnë sjelljen e nxënësit siç janë sëmundjet serioze, lindja e një fëmije të ri në familje, ndryshim në ilaqet që i merr fëmija - e që janë informacione që mund t'i ndihmojnë mësuesit. Prindi duhet t'a informoj mësimdhënësin për kontrollet dhe rekomandimet e dhëna nga mjekët, psikologët apo profesionistët tjerë që e kanë vlersuar fëmijën për të cilat nuk është i informuar mësimdhënësi. Në pjesën e edukimit, mësuesit duhet t'i ftojë prindërit e fëmijëve me aftësi të kufizuara të shohin klasën, mjedisin, duhet t'i informojnë ata rregullisht për përparimin e fëmijëve të tyre dhe të vendosin komunikim të rregullt.



Kur një fëmijë me nevoja nevoja të veçanta në arsim arrin moshën që prindi vlerëson se duhet të vijoj mësimi – disa informata ndihmuese për prindin janë të përmbledhura në vazhdim:

SA VJET DUHET TI KETË FËMIJA PËR TU REGJITRUAR NË SHKOLLË?

Fëmija duhet t'i ketë mbushur gjashtë vjet (që është moshë minimale për tu regjistruar), por mund të regjistrohet edhe nën moshën minimale të arsimit të detyruar në fillim të vitit shkollor me vlerësim të mjekut dhe të psikologut. Vendimin e merr Drejtoria komunale e arsimit.

ÇFARË DOKUMENTE DUHEN?

Për regjistrim në klasë të parë, fëmija duhet të ketë vetëm çertifikatën e lindjes. Megjithatë rekomandohet që nëse prindi ka në dispozicion edhe dokumente mjeksore të cilat tregojnë gjendjen shëndetësore të fëmijës (përfshirë diagnozat dhe terapitë, apo vlersime nga profesionistët tjerë), gjithashtu nëse fëmija ka vijuar kopshtin apo cilin parashkollorë, prindi bashkë me edukatoren e fëmijës mund të përpilojnë një dokument i cili shërben si profil i fëmijës në fjalë ku tregohen shkathtësitë dhe kompetencat që i ka përfutur fëmija gjatë frekuentimit të këtyre institucioneve si dhe vështirësitë me të cilat është ballafaquar fëmija – t'i paraqes gjatë procesit të regjistrimit. Gjithashtu në këtë dokument prindi mund të tregon se çfarë i pëlqen dhe çfarë nuk i pëlqen fëmijës. Kjo do ta ndihmojë fëmijën të adaptohet më lehtë në mjedisin e shkollës.

ÇKA NËSE FËMIJA NUK POSEDON ÇERTIFIKATË TË LINDJES?

Nëse fëmija është i regjistruar, atëherë në komunën ku ka lindur mund ta nxjerrin edhe çertifikatën e lindjes. Kërkesa për çertifikatë të lindjes bëhet tek zyrtari i gjendjes civile.

ÇKA NËSE FËMIJA NUK KA LINDUR NË SPITAL?

Në këtë rast nevojitet:

- Kërkesa për regjistrimin e lindjes;
- Vërtetimi nga institucioni shëndetësor për vaksinimin e kryer;
- Çertifikata e martesës për prindërit e fëmijës;
- Procesverbali për pranimin e atësisë, nëse fëmija është jashtëmartesor;
- Deklarata e së paku dy dëshmitarëve që kanë asistuar gjatë lindjes apo kanë njohuri të drejtpërdrejta për lindjen e fëmijës jashtë institucionit shëndetësor; dhe
- Fotokopjet e dokumenteve të identifikimit të prindërve të fëmijës;

ÇKA NËSE FËMIJA IM NUK KA LINDUR NË KOSOVË?

Në këtë rast ju nevojitet:

- Kërkesa për regjistrimin e lindjes;
- Çertifikata e lindjes ndërkombëtare apo ekuivalenti i lëshuar nga shteti i lindjes;
- Çertifikata e martesës për prindërit e fëmijës;
- Procesverbali për pranimin e atësisë nese fëmija është i lindur jashtë martese;
- Fotokopjet e dokumenteve të identifikimit të prindërve të fëmijës;

(Qartësim: Çertifikata e lindjes vlen për afat të pakufizuar, nëse nuk pëson ndryshime në të dhëna, përveç në rastin kur përdoret për martesë).

KUR DHE KU E REGJISTROJ FËMIJËN?

Regjistrimi i fëmijëve në klasë të parë fillon me 17 Maj dhe zgjatë deri më 7 Qershor. Fëmija regjistrohet te sekretari i shkollës. Prindi duhet të drejtohet në shkollë, gjegjësisht tek sekretari i shkollës i cili merret me regjistrimin e fëmijëve në shkollë. Sekretari gjithashtu mund t'ju ofrojë ndihmë dhe informata më të hollësishme për ta regjistruar fëmijën tuaj në shkollë.

ÇKA NDODH KUR TË REGJISTROJ FËMIJËN?

Nëse nuk jeni në dijeni që fëmija juaj ka nevoja të veçanta dhe nuk dispononi ndonjë vlerësim a diagnozë mjeksore - atëherë njejtë si të gjithë fëmijët e tjerë edhe fëmija i juaj bisedon me mësuesin, pedagogun e shkollës dhe psikologun. Edhe prindi apo kujdestari i fëmijës duhet të jetë i pranishëm. Gjatë bisedës do të shënohen: emri dhe mbiemri i fëmiut, ku ka lindur, çfarë kombësie dhe shtetësie ka fëmija. Gjithashtu do të shënohen edhe emrat e prindërve të fëmijës si dhe adresa; sa larg e ka fëmija shkollën; a ka qenë fëmija në parashkollor dhe a i njeh shkronjat; dhe a shkruan me dorë të djathtë apo të majtë. Vlerësimi dhe regjistrimi i nxënësit bëhet në prani të (së paku) njërit nga prindërit (gjegjësisht kujdestarit).

PSE BËHET KJO BISEDË?

Biseda fillestare bëhet që të vlerësohet se a është i pjekur fëmija për shkollë, a ka ndonjë problem në të pamur, dëgjim etj, apo thjesht a është i pjekur fëmija emocionalisht dhe intelektualisht. Pas bisedës to të kuptoni se a është pranuar fëmija juaj në klasë të parë dhe në cilën paralele do të shkojë. Nëse fëmija vlerësohet se nuk është i gatshëm për shkollë atëherë do të këshilloheni nga mësuesi, pedagogu dhe psikologu se çka duhet të ndërmerret dhe çfarë ndihme duhet ti ofrohet në rast se fëmija ka nevojë për tu vlerësuar nga ekipi profesional vlerësues i komunës suaj. Në disa raste fëmija mund të pranohet dhe të vlerësohet pas disa muajsh në ate se si po e përballon shkollën.

NË RAST SE PRINDËRIT HASIN PENGESA NË REGJISTRIMIN E FËMIJËVE TË TYRE ME NEVOJA TË VEÇANTA NË SHKOLLË, ÇFARË HAPASH MUND TË NDËRRMARIN?

Duke qenë se arsimimi parauniversitar nga niveli parashkollor deri në klasën e nëntë është arsim i obliguar sipas ligjit, atëherë të gjithë fëmijët duhen të jenë pjesë e tij. Nëse një fëmije me nevoja të veçanta i cënohet e drejta për regjistrim në shkollën më të afërt, atëher si prind duhet:

- T'i drejtoheni Drejtorisë komunale për arsim (zyrtarit për fëmijë me nevoja të veçanta dhe gjithpërfshirje) me kërkesë për vlerësimin e fëmijës suaj nga ekipi profesional vlerësues i komunës, dhe kësaj kërkesë ia bashkëngjitni edhe dokumentet tjera që janë përmendur më lartë;
- Fillimisht ekipi profesional vlerësues sjell një rekomandimit se fëmija duhet të ndjek shkollën e caktuar. Nëse shkolla në fjalë nuk ofron zgjidhje për fëmijën tuaj atëherë është e obliguar që të lëshon një dokument (vërtetim) me të cilin tregon arsyet për mospranim;
- Me këtë dokument si prind duhet ta paraqitni tek komuna gjegjëse për ta njoftuar Drejtorinë komunale të arsimit e cila do të gjej zgjidhjen për kycjen e fëmijës suaj në proces arsimor;
- Në çoftë se Drejtoria komunale e arsimit nuk gjen zgjidhje atëherë edhe nga ky institucion duhet të kërkohet me shkrim arsyeja e refuzimit;
- Hapi tjetër është Inspektoriati i arsimit në komunën gjegjëse (IAK) dhe gjetja e një zgjidhje. Në rast se as IAK nuk jep zgjidhje - atëherë si prind me dokumentacion të kompletuar dhe me kërkesë shtesë e njoftoni Departamentin e Inspektoriatit në MASHT.

NË RAST SË PRINDËRIT JANË TË PAKËNAQUR ME PROCESIN ARSIMOR, ÇFARË HAPASH MUND TË NËDERRMARIN?

- Në rast se prindërit janë të pakënaqur me mënyrë e trajtimit dhe procesin mësimor ankesën me shkrim mund ta paraqesin fillimisht tek drejtori i shkollës, e pastaj në Drejtorinë komunale përkatëse të arsimit dhe Inspektoriatin për arsim në regjion përkatës.



Edhe Fëmiju im
Ka të drejtë
Të Arsimohet



**Edhe Fëmiju im
Ka të drejtë
Të Arsimohet**

Doracak mbi gjithëpërfshirjen e fëmijëve me nevoja
të veçanta në institucionet arsimore

Prishtinë 2016